

**Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj takon Presidentin e Republikës së Polonisë, SHTZ Andrzej DUDA, Varshavë, 27 qershor 2019.**

Në datat 27-28 qershor 2019 u zhvillua në Varshavë, Poloni takimi i Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së. Takimi u organizua nga Gjykata Evropiane e Audituesve dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Polonisë. Ky aktivitet i organizuar në Varshavë vjen në vazhden e aktiviteteve për kremtimin e 100 vjetorit të krijimit të NIK-ut Polak.

Në këtë takim morën pjesë drejtues dhe përfaqësues të 28 vendeve anëtare të BE-së dhe të SAI-ve të vendeve kandidate dhe para kandidate, Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, z.Klaus-Heiner Lehner, anëtarë të kësaj Gjykate, anëtarë të Parlamentit European, Ministri i Çështjeve të Teknologjisë së Informacionit të Polonisë, përfaqësues të Komisionit Evropian, DG CNET, si edhe përfaqësues të SIGMA-s. KLSH në këtë takim u përfaqësua nga një delegacion i kryesuar nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj, Zv. Kryetari, znj. Lindita Milo dhe Specialiste në Drejtorinë e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Alma Shehu.

Sfidat dhe mundësitë e institucioneve supreme të auditimit në Europën dixhitale kanë qenë tema kryesore e diskutimit në takimin e Komitetit të Kontaktit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit European, në të cilin ekspertë të fushës dhe drejtues të SAI-eve paraqitën eksperiencat për rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm të SAI-eve në këtë proces.

Zhvillimet e teknologjisë së informacionit gjithjë e më tepër kanë parashtruar sfida të vazhdueshme për SAI-et për zhvillimin e kapaciteteve dhe metodologjitve të domosdoshme për të realizuar auditime cilësore të këtij aspekti me impakt në shërbimet që qeveritë ju ofrojnë qytetarëve.

*Burimi: Faqja zyrtare e internetit e NIK, [www.nik.gov.pl](http://www.nik.gov.pl)*

Epoka e re e zhvimeve të shpejta të teknologjisë së informacionit është tashmë promotore e shumë zhvillimeve social –ekonomik në vende të ndryshme në Evropë e më gjerë. Qeveritë e këtyre vendeve gjenden para sfidave që paraqet përdorimi në çdo fushë i teknologjisë së informacionit, adresimi i të cilave uli në një trzezë të përbashkët anëtar të parlamentit European si politikë bërës dhe përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit si mbikëqyrës të mirëqeverisjes. Ashtu siç nënvizoi anëtari i parlamentit Evropian, z. Michal Boni “Afhenda e dixhitalizimit të Evropës, e cila ka në fokus qeverisjen e mençur (smart govenance) që synon thjeshtëzimin e shërbimeve publike, dixhitalizimin e shërbimeve publike dhe aksesin publik të informacionit nëpërmjet TI dhe nëpërmjet implementimit të sukseshëm të saj, kërkon të arrijë rritjen e qenësishme të cilësisë së demokracisë dhe performancë të sukseshme të politikave për zhvillimin e qenësishëm të vendeve anëtare”.

Lidhur me sfidat me të cilat përballen institucionet e auditimit kur ato auditojnë procese të ndryshme të shërbimeve publike të dixhitalituara, përfaqësuesja e Komisionit Evropian, DG CNECT, znj. Nikowska dhe Audituesin e Përgjithshëm të Finlandës, znj. Tytti Yli-Viikari

theksuan se këto institucione duhet të jenë të vetëdijshme për risqet që lidhen me sigurinë, mjetet dhe metodologjitë e përdorura, njohuritë që kanë stafet e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit dhe vizioni që ato kanë për mikqyrjen e politikave qeveritare në fushën e e-governance. Për këtë SAI-et duhet të fokusohen në sigurimin cilësor të resurseve teknologjike dhe njerëzore, rritjen e kapaciteteve të stafit dhe zhvillimin e metodologjive të suksesshme të teknikave të auditimit.

Pjesë e axhendës së aktivitetit ishte edhe raportimi i grupeve të ndryshme të punës së EUROSAT-t lidhur me praktikën e mira gjatë kryerjes së auditimeve të koordinuara dhe paralele, ndër të cilat mund të përmenden auditimi për cilësinë e ajrit, pjesë e të cilit ka qenë dhe KLSH dhe auditimi me temë se si të menaxhohet infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sektorin publik.

*Takimi me Presidentin e Republikës së Polonisë, SH.T.Z Andrzej Duda*  
*Burimi: Faqja zyrtare e internetit e NIK, [www.nik.gov.pl](http://www.nik.gov.pl)*

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti drejtuesit e SAI-eve pjesëmarrëse u pritën nga Presidenti i Republikës së Polonisë, SH.T.Z Andrzej Duda, i cili shprehu vlerësimin për rolin dhe kontributin e institucioneve supreme të auditimit në konsolidimin e eficiencës dhe efektivitetit në një fushë kaq të rëndësishme siç është dixhitalizimi i qeverisjes, e cila duhet të synojë jo vetëm përfaqësimin por edhe përfshirjen e qytetarëve në procese të ndryshme të qeverisjes dixhitale. Presidenti Duda tha se Zyra Supreme e Auditimit ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e Polonisë si një shtet që bazohet në të njëjtat standarde mbi të cilat janë ndërtuar dhe funksionojnë shtetet demokratike të Evropës Perëndimore.

Në dy ditët e takimit të Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së, Kryetari i KLSH-së zhvilloi takime pune me Presidentin e SAI-t Polak, z. Kwiatkowski, Presidentin e SAI-t të Portugalisë, z. Caldeira, Audituesin e Përgjithshëm të Finlandës, znj. Tytti Yli-Viikari, Presidentin e SAI-t të Çekisë, z. Kala, Presidentin e SAI-t të Rumanisë, z. Busuioc, Audituesin e Përgjithshëm të Qipros, z. Michaelides, Presidentin e SAI-t të Malit të Zi, z. Dabović, Anëtarin e Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Wojciechowski, Zv. Presidentin e NIK-ut polak, z. Kutyla dhe Zv. Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Ademi.

Në vijim të marrëdhnieve të shkëlqyera të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ndërsjelltë të eksperiencave, gjatë muajit gusht Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj do të presë në një vizitë zyrtare Presidentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, z. Kwiatkowski dhe Presidentin e SAI-t të Rumanisë, z. Busuioc.